Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**01.02.2023**	**06.02.2023**	**2023/0054**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me daten: 30.01.2023, OE "Rojet E Nderit SH.P.K."- Prishtine, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0054, kunder njoftimit per kontrate, kunder anulimit te aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve te Komunes se Gjakoves" me nr. te prokurimit: "632-22-6005-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratws shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 340,000 €.

Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotesuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Të nderuar pas njoftimit për kontratë neve kemi shkarkuar DT dhe kemi plotësuar ofertën me të gjitha kërkesat tuaja ku si kriter për dhënje të kontratës ishte

Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**

Dhe si kushtë nga ana juaj ishte që **Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se**

punëtorëve do t'iu paguaj pagën neto minimum 280,00€.

Deklarata e nënshkruat dhe vërtetuar.

Ne kemi kalkuluar konform kërkeses tuaj dhe kemi ofruar çmim pre 2.15 euro për orë pune ku kemi

plotësuar të gjitha kërkesat tuaja.

Me datë 21.12.2022 keni kërkuar sqarim lidhur me çmimin jo-normalisht të ulët.

Me datë 23.12.2022 kemi dërguar sqarimin ku kemi cekur

Për: KOMUNA E GJAKOVËS

Nga: "ROJET E NDERIT" SHPK 23.12.2022

LËNDA: SQARIM PËR KËRKESEN NGA Z.P K.K GJAKOVE.

Të nderuar

Ju shkruajm lidhur me Aktivitetin e Prokurimit me titull: Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës dhe nr prokurimi: 632-22-6005-2-1-1.

Me datë: 21.12.2022 keni kërkuar nga ne sqarime lidhur me çmimin e dhënë nga ana jonë ne ju sqarojm si më poshtë:

Kërkoses dosjes tuaj ka qenë që të jepet çmimi për orë pune .

Ne kemi dhënë çmimin për orë pune me të gjitha kërkesat tuaja, por për hirë të korrektësis gjeni të pasqyruar ANALIZËN e detajuar.

	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve Kalkulimi për një punëtorë	Vlera
1	Paga neto për orë të dites	280.00
2	Tatimi në burim	10.00
3	Trusti pensional 5% i punëmarresit	15.26
4	Trusti pensional 5% i punëdhënësit	15.26
5	Fitimi	0.15
6	Gjithsej kostoja për një punëtorë dhe kontributet	320.67
7	Kostoja për një punëtor pjestuar për 176 orë pune	1.82
8	Plus 18% TVSH-ja	0.33
9	Cmimi i përfundimtar më TVSH per një orë pune	2.15

Me respekt.

Ne nuk kemi bërë ndonjë ndryshim në çmimë ose formular të çmimit vetëm se kemi detajizuar se si kemi ardhur deri tek çmimi për njësi në vlerë prej 2.15.

Por për qudi me datë 13.01.2023 kemi pranuar letëren standarte për tenderuesin e eliminuar pa ndonjë bazë dhe veprim krejt të kundërt me atë që thotë LPP

Sa për sqarim dhe mirë kuptim ne po citojm LPP:

Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

Si dhe Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve i RRUOP me nr **82/2022**

Pika 40.10 nenpika b

Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total **në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet**

Ne në formularin e çmimit kemi plotësuar këtë formë:

Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës	orë	151424	2.15	325,561.60
Gjithsej totali me TVSH					**325,561.60**

Pra këtu vrehet qartë se nuk ka ndonjë mospërputhje dhe kërkojm nga ana juaj të na sqaroni se ku e keni zbuluar gabimin aritmetik dhe pse jeni thirrur në diqka që realisht është imagjinuar/shpikur nga ana juaj pasi që ne kemi ofertuar konform këreksave tuaja dhe nuk egziston një gabim i tillë. Pasi qe nuk egziston ndonjë mos përptuhje e tillë siq ju pretendoni.

AK në vendimin e kërkesës për ri-shqyrtim I ka ikur shqyrtimit thelbësor por vetëm është mundur ta shpreh në form ireale formen e llogaritjes se kalkulimit të gabimeve aritmetike prej më shumë se 2%.

Për sa u tha më lartë kërkojm që të APROVONI ANKESEN tonë dhe lënden ta këtheni në rivlerësim duke shpallur ofertën tonë si më të lirën të përgjegjëshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

	5.5	**340 000,00€**	
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**apaciteti teknik he professional:** **Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka** **përfunduar me sukses kontrata të natyrës së** **ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar** **nga data e publikimit të njoftimit për**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Lista e kontratave në të cilën specifikohen të** **gjitha punët e realizuara në 3 (tri) vitet e** **shkuara, duke saktësuar sherbimet e kryera** **shumën e kontratës,**

			kontratë. **Në një vlerë prej jo më pak se 510.000,00€, në rast** **konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60%** **kontrata të natyrës së ngjajshme.** **Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 38 (tridhjetë e tetë punëtor me licenca të sigurimit themelor,licenca të jetë valide) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm për kryerjen e projektit si ne vijim a) Një Menaxher I shërbimit themelor me diplome universitare, trust pensional, licence të menaxherit nga MPB (5 vite provoj pune) b.)**	**datën e pranuesit ose** **certifikatën e ekzekutimit të mire të sherbimëve –** **(referencë ose raport të pranimit të punëve e** **cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se** **Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe** **referenca me Operator Ekonomik privat** **atëherë Operatori Ekonomik duhet të** **prezanton situacionet e nënshkruara së bashku** **me transaksionin bankar, që**	

			Një Menaxher për vezhgim dhe monitorim elektronik shkolla e mesme licence të jetë valide,c.) Një Menaxher për siguri dhe shendet ne pune certifikata nga MPMS, kontrat apo marreveshje per angazhim , trust pensional,d.) Një Mbikqyrës të vezhgimit elektronik me licens valide(OME).	**përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.** Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin. si dhe lista e numrit të punëtorëve	

				të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.	
			Operatori Ekonomik duhet të ofrojë Memorandum me ndonje kompani të licencuar për trajnimin e punëtorve-trajnim themelor professional dhe trajnim te specializuar, certifikata dhe licenca valide e istitucionit trajnues	**Memorandum, certifikata dhe licenca valide e istitucionit trajnues (kopje)**	
			Operatori Ekonomik duhet të deklarohet se punëtorëve do t'iu paguaj pagën neto minimum 280,00€.	**Deklarata e nënshkruat dhe vërtetuar.**	

			Për pikat me siper Autoriteti Kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike e profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [4]

Gjakovë 12.01/2023

Komuna e Gjakovës, Rruga UÇK (ndërtesa e ish Bankosit) Zyra e Prokurimit kati I-rë Gjakovë

Për: **Rojet E Nderit SH.P.K., Prishitnë, 10 000, Prishtinë**

Nr. i prokurimit	**632-22-6005-2-1-1**
Nr i brendshëm	**632-22-052-2-1-1**

Titulli: Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës

I nderuar Z.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM
Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :
- Ju si Operator Ekonomik edhe pas kërkesës për sqarim te ber nga AK-ja keni prezantuar sqarimin (ANALIZËN e detajuar, kalkulimi për punëtor),ku sipas kalkulimit te ber nga ajan juaj por nuk e keni llogaritur TVSH-në ,Sqarimit tuaj kur ti llogaritet edhe TVSH-në del se ju keni tejkaluar vlerën e parashikuar dhe vlerën mbi 2%.
Ku në bazë të:

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

[4] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojes).*

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Rojet E Nderit SH.P.K.**

Pretendimi kryesor sipas ankesës 54/23 ka të bëjë me arsyetimin e AK-së për eliminim të OE ankues, ku sipas AK-KK Gjakovë i njëjti ka gabim aritmetikorë mbi 2% të cmimit total dhe të njëjtit po ti aplikohet TVSH i njëjti tejkalon vlerën e parashikuar nga AK prej 340,000€.

OE ankues pretendon se të njëjtit nuk kanë asnjë gabim aritmetikor dhe se cmimi është ofruar me cmim njësi duke përfshirë TVSH-në, dhe cmimi total të ofertës prej 325.561.61€.

Theksojmë se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që paga neto për një punëtor duhet të jetë jo më pak se 280€, ku njëkohësisht në paramasë kanë përcaktuar se duhet të jenë 38 punëtor, ndërsa kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, kërkesave të dosjes së tenderit si dhe sqarimeve të kërkuara nga AK për analizë të cmimit dhe sqarimeve të ofruara nga OE ankues, mendimi i ekspertit shqyrtues është cmimi total prej 325.561.61€ pas pagesës së TVSH-së nuk arrinë të mbuloj pagat neto të punëtorëve.

Më tutje sqarojmë se sipas kalkulimeve tona vlera e parashikuar nga prej 340,000€ e bënë të pamundur realizimin e kësaj kontrate, për arsye se vlera minimale e nevojshme për të mbuluar vetëm pagat neto prej 280€ tejkalon shumën 344,000€.

Në këto rrethana qdo OE që ofron cmim edhe 100% sipas vlerës të parashikuar nga AK ose më të ulët

nuk do të arrijë të mbuloj pagat e punëtorëve, ndërsa qdo OE që ofron cmim i cili mbulon pagat e punëtorëve prej 280€ neto do të tejkaloj vlerën e parashikuar nga AK dhe të njëjtit mund të eliminohen ashtu si ka vepruar AK me OE tjerë.

Vlerësojmë se planifikimi i këtij prokurimi dhe parashikimi i vlerës nuk është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 17 par.1 të LPP-së dhe sipas mendimit tonë e bënë të pamundur të shpërblehet me kontratë cili do OE pavarësisht cmimit që ofron ai.

Sipas mendimit të ekspertit OE ankues në asnjë rrethanë nuk mund të jetë fitues i kësaj kontrate, edhe pse përgjëgjësia kryesore për pamundësimin e realizimit të këtij prokurimi bie mbi autoritetin kontratues, vlerësimi dhe rekomandimi jonë është që ankesa e OE ankues të hudhet e palejuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E GJAKOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Rojet E Nderit SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Ilir Halili